



## **Si te paiseni falas me kodin Pin per te perfituar nga sherbimet online te Agjensise se Finances dhe te Deklarates Unike (Certificazione Unica) te INPS-it.**

Agjensia e Tatim Taksave dhe INPS informojne mbi menyren me te mire per te perballuar me skadencat fiskale.

Regjistrohuni ne Fiscoonline per tu pajisur me fjalekalimin dhe PIN-in ne menyre qe te perdorni falas sherbimet telematike te Agjensise, si 730 i para-plotesuar. Kerkesa mund te paraqitet online, nepermjet telefonit ose duke u drejtuar personalisht ne cfare do lloj zyre te Agjensise se Tatimeve, ne menyre qe tu jepet mundesia te gjithë qytetareve te zgjedhin ne varesi te kerkesave e mundesive te tyre. Persa i perket Deklarates Unike te te Ardhurave, pensionistet dhe te asistuarit INPS mund te pajisen lehtesishte me te duke u lidhur ose online, ne adresen internet te INPS-it, neqoftese disponojne kodin PIN te leshuar nga vete INPS-i, ose nga patronatet. Kerkesa e kryer nepermjet qendrave CAF dhe ndermjetesave te specializuar, eshte e njejta por ne disa raste mund te jete me pagese.

### **Codi Pin i Agjensise se Tatimeve: si te paisen falas me te**

Kontribuesit qe deshironje te perdorin sherbimet online te Agjensise, duke perfshire dhe Deklaraten e para-plotesuar, mund te kerkojne falas PIN-in dhe password-in personal duke u lidhur online ne adresen internet te Agjensise, nepermjet telefonit, duke u paraqitur ne nje nga zyrat e Agjensise se Tatimeve personalisht ose duke deleguar nje person te trete. Neqoftese kerkesa paraqitet ne Agjensi personalisht nga personi i interesuar i leshohet pjesa e pare e kodit PIN dhe password-i per te bere hyrjen e pare ne sistem dhe, pjesa e dyte e tije i leshohet mbasi eshte futur ne proceduren online. Per t'ju garantuar siguri perdorueseve qe kerkojne sherbimet online, te cilet nuk paraqiten personalisht ne Agjensi, procedura parashikon qe pjesa e pare e PIN-it tu leshohet menjehere ndersa pjesa e dyte e tije, me password-in per te kryer hyrjen e pare online, u dergohet me poste ne vendbanimin e deklaruar ne zyrat e Agjensise se Tatimeve.

### **Deklarata Unike e te ardhurave (certificazione unica) pa kosto, online**

Per pensionistet dhe puntoreve qe gjate vitit 2014 kane perfituar ndihme sociale nga INPS modeli i Deklarates Unike, i nevojshem per te kryer deklarimin e te ardhurave vjetore personale, eshte i disponueshem online ne adresen internet te INPS-it ne piken "Servizi al cittadino" (sherbimet ndaj qytetarit). Per te shfrytezuar kete sherbim eshte e domosdoshme pajisja me kodin PIN. Kush nuk e disponon nje kod te tille, mund te kerkoje falas Deklaraten Unike 2015 (Certificazione Unica) ne patronatet e zones. E njejta certificate mund te kerkohet edhe ne zyrat CAF ose nepermjete ndermjetesave te autorizuar te cilet mund te kerkojne nje pagese per dhenien e ketij sherbimi.

Si rrjedhoje e takimit te presidentit te INPS-it dhe te Keshillit Kombetar te CAF-eve u vendos qe te gjithë CAF-et qe marin pjese ne Keshillin Kombetar te CAF-eve do garantojne falas sherbimin e Deklarates Unike.

Torino, 15 prill 2015

Giovanni Firera  
Responsabile

Informazioni Istituzionali e Relazioni con il Pubblico